

PROCESVERBAL

Tipi i kontratës - Shërbime

Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i Procedurës: Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër **-Mbikqyrja e punimeve per objektin: Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Azem Hajdari", Zall-Mner, Bashkia Kamëz.**

Vlera e fondit limit: **2,912,637**(dy milion e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa tvsh

CPV: Mbikqyrja e punës së ndërtimit

Në bazë të Aktit Normativ Nr. 9, Datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me ligjin 97/2019, VKM 199/2020 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit për punët, shërbimet dhe mallrat, kriteret e vlerësimit të ofertës fituese, kushtet e marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për rindërtimin” nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, **Bashkia Kamez** i ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Objekti: **Mbikqyrja e punimeve per objektin: Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Azem Hajdari", Zall-Mner, Bashkia Kamëz.**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;
- c. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5;
- ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- d. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 10;
- e. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas shtojcës 11.
- ë. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen ne VKM 199/2020 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit për punët, shërbimet dhe mallrat, kriteret e vlerësimit të ofertës fituese, kushtet e marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për rindërtimin”.

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 9

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2019, 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të **marrëveshjes kuadër**

Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmimin e tyre.

Argumentimi për kriterin 2.2.1: Ky kriter është vendosur në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, bazuar në nenin 42 të Aktit Normativ 9/2019, nenin 77, pika 3, e LPP dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nen kufirin e ulët monetar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Autoriteti në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji

b).Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2019-2020-2021**, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit. **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës **së parashikur të marrëveshjes kuadër**

Në rastin e përvojës së mëparshme nga një ent publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuar nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës të lotit, të realizuara në tri vitet e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi

2.3.2 Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore:

- | | |
|---------|--|
| N.P – 1 | Punime gërmimi në tokë. |
| N.P – 2 | Ndertime civile dhe industriale |
| N.P – 3 | Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industrial , veshje fasade. |
| N.P – 7 | Ujesjellesa, gazsjellesa. vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje |

- N.P – 11 Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- N.P – 12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- N S – 1. Punime për prishjen e ndertimeve
- N S – 2. Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre
- N S – 4. Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese.
- N.S – 8 Ndertime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri
- N.S – 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- N.S – 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV
- N.S – 18 Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në liçencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korrespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në liçencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë liçencën përpara lidhjes së kontratës dhe fillimit të punimeve sipas legjislacionit përkatës të punimeve sipas legjislacionit përkatës.

Argumentimi 2.3.2: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 759 datë 12.11.2014 “Për liçencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Kategoritë janë kërkuar bazuar në listen e zërave dhe vlerat e punimeve. Liçencat janë të lidhura ngushtësisht me volume të punimeve të ndërtimit dhe projektin e zbatimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.3 Staf kryesor i inxhinierëve të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit është;

(Inxhinier Ndërtimi)		1(një)
Arkitekt/Urbanist	minimumi	1(një)
Inxhinier Gjeodet	minimumi	1(një)
Inxhinier Elektrik	minimumi	1(një)
Inxhinier Hidroteknik	minimumi	1(një)

Inxhinieret e mësipërm duhet të jenë pjesë e stafit të shoqërisë dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën ((**Korrik 20022 - Shtator 2022**)). Për te vertetur plotesimin e këtij kushti, për secilin prej inxhinierëve të lartpërmendur Operatoret Ekonomike duhet të paraqesin:

- kualifikimet arsimore (diplomat),
- kualifikimet profesionale licenca,
- CV, si dhe listepagesat.

Argumentimi 2.3.3: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projektin dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objekteve arsimore në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

**Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë jo më pak se **7 (shtate)** punonjës të siguruar për çdo muaj për periudhën ((**Korrik 20022 - Shtator 2022**)). Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë;

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për periudhën ((**Korrik 20022 - Shtator 2022**)) shoqëruar me listepagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor.

Argumentimi: 2.3.4: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, afati i realizimit të kontrates, orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje ((**Korrik 20022 - Shtator 2022**)). tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i

punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

**Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.*

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Termet e references janë pjesë e DST.

Njësia e Prokurimit